

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 110/19) dhe nenin 56 paragrafin (9) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

**Rregullore
për mënyrën e sigurimit të mjeteve
për programin ndërkombëtar të arsimit fillor (programi IB)**

Neni 1

Me këtë akt përcaktohet mënyra e sigurimit të mjeteve për programin ndërkombëtar të arsimit fillor (programi IB)

Neni 2

Mjetet për realizimin e programit ndërkombëtar të arsimit fillor (programi IB) për shkollën fillore në të cilën realizohet programi ndërkombëtar, miratohet nga Ilogaria e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nga Programi 2 - Arsimi Fillor, Nënprogrami 22 - Arsimi Fillor Ndërkombëtar, pas kërkesës së dorëzuar më parë nga shkolla fillore dhe dokumentacionit përkatës.

Neni 3

Mjetet nga neni 2 i kësaj Rregullore miratohen për qëllimet e mëposhtme:

- kuota anëtarësie (konform dokumentit nga International Baccalaureate Organisation, Geneve, Switzeland);
- trajnime për realizimin e programit ndërkombëtar (konform dokumentit nga International Baccalaureate Organisation, Geneve, Switzeland);
- shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimin në hotel në lidhje me trajnimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
- përdorimin e shërbimeve të korrierit dhe shërbimit DHL;
- shqyrtimin e kandidatëve;
- tekstet shkollore, literatura dhe botime të tjera profesionale për bibliotekën e shkollës fillore;
- materialet e zyrës;
- mjetet ndihmëse mësimore;
- shpenzimet për punë në laborator kimik;
- pajisjet mësimore për procesin edukativo-arsimor;
- riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme (e pajisjeve mësimore dhe softuerit);
- provizion bankar dhe diferencë në kursin valutor gjatë blerjes së valutës së huaj;
- shërbime për përkthimit;
- softuer arsimor

Neni 4

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mjetet nga nenet 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje i transerojnë në llogarinë e shkollës në të cilën realizohet programi ndërkombëtar për arsimin fillor.

Neni 5

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, ndalojnë së vlefshmi Udhëzimet për mënyrën e sigurimit të mjeteve për realizimin e programit ndërkombëtar për arsimin fillor nr. 11-2030/1 të datës 23.04.2013 dhe nr. 11-2030/2 të datës 17.06.2013.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e sjelljes së tij.

Министерка за образование и наука
Ministre e Arsimit dhe Shkencës
проф. д-р Весна Јаневска, с.р

Бр./Nr. 12-12556/1
25.09.2025 г.в.
Скопје/Shkup

